



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 11.3, pikat **b** dhe **i** të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30, për ndryshimin e Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, shpallur më 16 tetor 2007, nenit 6 dhe 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/29, për tatimin mbi pronën e palutjshme në Kosovë dhe të nenit 66 shkronja **a**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2008, merr

V E N D I M
PËR ZBRITJEN E KOEFICIENTIT TË TATIMIT NË PRONË

Neni 1

Miratohet Vendimi për zbritjen e koeficientit të tatimit në pronë.

Neni 2

Normat ekzistuese të deritashme për pagesën e tatimit në pronë, sipas këtij përshkrimi do të zvogëlohen:

- Pronat e domosdoshme për qëllime banimi, nga ekzistuesja 0.15% në 0.11%;
- Pronat rezidenciale, nga ekzistuesja 0.15% në 0.11%;
- Pronat komerciale, nga ekzistuesja 0.23% në 0.17%;
- Pronat industriale, nga ekzistuesja 0.18% në 0.13%;
- Pronat e braktisura, nga ekzistuesja 0.15% në 0.11%;
- Pronat e papërfunduara, nga ekzistuesja 0.15% në 0.11%;
- Garazhet, nga ekzistuesja 0.15 në 0.11%;

Neni 3

Bazë për llogaritjen e normave nga neni 2 i këtij Vendimi, është shprehja e pronës në m², e kalkuluar nga matjet e mureve të jashtme duke llogaritur sipërfaqen e etazheve (kateve), dhe e aplikuar në bazën e vlerës së tregut që është objekt i tatimit sipas këtij Vendimi.

Sipërfaqja nga paragrafi 1 i këtij neni, do të zvogëlohet për 50% nga sipërfaqja e katit të plotë për sipërfaqet e etazhit të nënkulmit.

Neni 4

Zbritja e normës së tatimit sipas këtij Vendimi, është paraqitur në mënyrë tabelare si shtojcë e këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatim të këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ndërsa do të aplikohet për ngarkesat e këtij lloji tatimi për vitin fiskal 2009.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 .№ 110-386, më 04.04.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa

PROPOZIMI I RI :

Nga të dhënat e lartëcekura,propozohet të zbritet koeficienti i dertashme për 25%

Në mënyrë tabelare pasqyrohet llogaritja e tatimit në pronë me koeficiente aktuale dhe ato të reja.

DESTINIMI I PRONAVE	M ²	VLERA E M ²	VLERA E PERGJITHSHE	ZBRIJA SIPAS RREGULLORËS 2003/29	BAZA PER LLOGARITJEN E TATIMIT	KOFICI ENDET	SHUMA E TATIMIT	DIFERE NCA	ZONA-KATEGOR IA
BANESA koeficienti i vjetër	61	560.00	34,160.00	10,000.00	24,160.00	0.15	36.24	9.67	I-B
II-I-II-II-II- koeficienti i ri	61	560.00	3,416.00	10,000.00	24,160.00	0.11	26.57		II-II
SHTËPI koeficienti i vjetër	157	760.00	119,320.00	10,000.00	109,320.00	0.15	163.98	43.73	I-B
II-I-II-II-II- koeficienti i ri	157	760.00	119,320.00	10,000.00	109,320.00	0.11	120.25		II-II
LOKALE koeficienti i vjetër	63	1,220.00	76,860.00	xxxxx	76,860.00	0.23	176.78		II-A
II-I-II-II-II- koeficienti i ri	63	1,220.00	76,860.00	xxxxx	76,860.00	0.17	130.66	46.12	II-II
DEPO koeficienti i vjetër	600	440.00	264,000.00	xxxxx	264,000.00	0.23	607.20	158.40	II-A
II-I-II-II- koeficienti i ri	600	440.00	264,000.00	xxxxx	264,000.00	0.17	448.80		II-II
OBJEKTET INDUSTRIALE	113	400.00	45,200.00	xxxxx	45,200.00	0.18	81.36		II-B
II-I-II-II-II- koeficienti i ri	113	400.00	45,200.00	xxxxx	45,200.00	0.13	58.76	22.60	II-II
FUSHAT SPORTIVE	990	230.00	227,700.00	xxxxx	227,700.00	0.23	523.71		II-B
II-I-II-II-II- koeficienti i ri	990	230.00	227,700.00	xxxxx	227,700.00	0.17	387.09	136.62	II-II
GARAZHAT koeficienti i vjetër	62	260.00	16,120.00	10,000.00	6,120.00	0.15	9.18		I-B
II-I-II-II-II- koeficienti i ri	62	260.00	16,120.00	10,000.00	6,120.00	0.11	6.73	2.45	II-II

Në tabel janë përfshir pronat që tatimohen për disa zona me kategori.